



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 28. 10. 2025

URDHËR

Nr. 554, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT MËSIMOR TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 45 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit mësimor të arsimit bazë dhe rregullave për zbatimin e tij, përkatësisht sipas shtojcave 1 dhe 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
 2. Ky plan mësimor fillon zbatimin si vijon:
 - a) Për klasën e parë dhe klasën e gjashtë në vitin shkollor 2026-2027;
 - b) Për klasën e dytë dhe klasën e shtatë në vitin shkollor 2027-2028;
 - c) Për klasën e tretë dhe klasën e tetë në vitin shkollor 2028-2029;
 - d) Për klasën e katërt, klasën e pestë dhe klasën e nëntë në vitin shkollor 2029-2030.
 3. Urdhri nr.203, datë 25.04.2025 “Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë” shfuqizohet sipas fillimit të zbatimit të planit mësimor në klasat e sipërcituara.
 4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



Adresa: Rruga e Durrësit, nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

Shtojca 1. Plani mësimor i arsimit bazë (në orë mësimore/javë)

Nr.	FUSHAT DHE LËNDËT	KLASAT								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
1	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	10	10	9	8	8	10	10	10	10
1.1	Gjuhë shqipe	8	8	6	5	5	5	5	5	5
1.2	Gjuhë angleze	2	2	3	3	3	3	3	3	3
1.3	Gjuhë e huaj e dytë						2	2	2	2
2	MATEMATIKA	4	4	4	4	4	4	4	4	4
2.1	Matematikë	4	4	4	4	4	4	4	4	4
3	SHKENCAT E NATYRËS	1	1	1	2	2	2	4	6	6
3.1	Dituri natyre	1	1	1	2	2				
3.2	Fizikë						1	2	2	2
3.3	Kimi								2	2
3.4	Biologji						1	2	2	2
4	SHKENCAT SHOQËRORE	1	1	1	2	2	3	5	5	5
4.1	Qytetari	1	1	1	1	1	1	1	1	1
4.2	Histori				1	1	1	2	2	2
4.3	Gjeografi						1	2	2	2
5	ARTET	2	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2	2
5.1	Muzikë	1	1	1	1	1	1	1	1	1
5.2	Art pamor	1	1	1	1	1	1	1	1	1
5.3	Kërcim		0.5	0.5	0.5					
5.4	Teatër					0.5	0.5	0.5		
6	EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	3	3	3	3	3	3	3	3	3
6.1	Edukim fizik, sport dhe shëndet	3	3	3	3	3	3	3	3	3
7	TEKNOLOGJIA DHE TIK-U	1	1	2	2	2	1	1	1	1
7.1	TIK	1	1	1	1	1	1	1	1	1
7.2	Aftësim teknologjik praktik			1	1	1				
	KURRIKULA BËRTHAMË	22	22.5	22.5	23.5	23.5	25.5	29.5	31	31
8	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	1	1	1	1	1	1	1	1	1
	TOTALI (ORË MËSIMORE JAVORE)	23	23.5	23.5	24.5	24.5	26.5	30.5	32	32

Shtojca 2. Rregulla për zbatimin e planit mësimor të arsimit bazë

- 1) Në planin mësimor të arsimit bazë, kurrikula përbëhet nga *kurrikula bërthamë* dhe *kurrikula në bazë shkolle*.
- 2) Për lëndën "*Gjuha e huaj e dytë*", e cila zhvillohet si lëndë e kurrikulës bërthamë në klasat 6 - 9 , nxënësi mund të zgjedhë të zhvillojë si gjuhë të huaj të dytë, njërin nga gjuhët: gjuhën frënge, gjuhën italiane, gjuhën gjermane dhe gjuhë të tjera sipas specifikave të institucionit arsimor.
- 3) Të gjitha institucionet arsimore parauniversitare publike, që në zbatim të marrëveshjeve dhe memorandumeve të mirëkuptimit mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Francës/ Republikës Federale të Gjermanisë/Republikës së Italisë, janë përcaktuar nga njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar për mësimin e gjuhëve të huaja: *frengjisht, gjermanisht dhe italisht*, duke filluar nga klasa e 3-të, krahas gjuhës angleze, në kurrikulën bërthamë do të zhvillojnë me 3 orë mësimore në javë edhe gjuhën e huaj përkatëse sipas marrëveshjeve/memorandumeve dypalëshe.
- 4) Lënda "*TIK*" zhvillohet në kurrikulën bërthamë që në klasë të parë duke filluar zbatimin në të gjitha shkollat që pajisen me SmartLab-e.
- 5) *Kurrikula në bazë shkolle* është pjesë e kurrikulës së përgjithshme dhe e detyruar që të zhvillohet nga nxënësi. Kjo kurrikulë zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së përcaktuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, nevojat dhe njohuritë paraprake të nxënësve, si dhe me mundësitë e shkollës, specifikat rajonale dhe kërkesat e kohës. *Kurrikula në bazë shkolle* është pa vlerësim me notë.
- 6) Në kurrikulën në bazë shkolle zhvillohen module kurrikulare ose veprimtari të tjera shkollore sipas interesave të nxënësve. Ajo ka si qëllim:
 - a) të ofrojë module, të cilat trajtojnë tema ndërkurrikulare që kanë lidhje me problematikat shoqërore, kulturore, mjedisore, natyrore, aftësitë për jetë etj.
 - b) të krijojë mundësi për zhvillimin e kurrikulës në nivel lokal.
 - c) të nxisë të mësuarin me projekte si p.sh., projekte që nxisin zbatimin e qasjes STEM, ose projekte në fusha të tjera që mundësojnë një nivel të lartë integrimi kurrikular dhe zbatime në situata praktike të jetës së përditshme.
- 7) Modulet në kurrikulën në bazë shkolle mund të zgjidhen nga lista e moduleve të hartuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ose mund të hartohen nga vetë shkolla në varësi të interesave dhe të nevojave të nxënësve. Modulet e hartuara nga shkolla miratohen nga zyra vendore arsimore përkatëse.